



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 04-104-02-26501-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 05.09.2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Guvernment

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilič

Datë/Data/Date	05.09 2025
Për/ Za/To	Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuese e Kuvendit Komunal
Përmes/ Preko/Through	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës Zarife Behluli, Drejtoria për Ekonomi, Financa
Nga/ Od/From	Afërdita Hashani, Sektori i Tatimit në Pronë
Tema/Subjekat/Subjekt:	Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2026

E nderuar

Ju lutem pranoni propozim vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2026, kërkojme nga ju të futet në rend dite për mbledhjen e kuvendit shtator 2025. Normat tatimore caktohen konform nenit 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronë e Paluajtshme.paragrafi 1 dhe nen paragrafet 1.1 deri ne 1.9.

Ju faleminderit për bashëpunim!



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Ligjit Nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme sipas Neni 39 /A Shkalla tatimore tranzitore dhe Nenit 83 pika 19 të Statutit të Kuvendit Komunal të Obiliqit Nr; I -34 të dt 25.04.2016 Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim e Komunës së Obiliqit propozon këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026

Neni 1

Shkalla tatimore progresive

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2026 për të gjitha vlerat e pronave në territorin e Komunës së Obiliqit, sipas vlerës së kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:

- 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
- 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni;
- 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
- 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni; dhe
- 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50%**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform nenit 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Ky vendim shfuqizon vendimin Nr.- 01-060-01-29563-24 të datës ; 30.09..2024

Neni 4
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës, dhe do të fillojë së zbatuari nga data 01 Janar 2025

Vendimi Nr. _____
Dt;

Kryesuese e Kuvendit
Vlora Mjekiqi Kabashi
